



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:031603

Datë: 30.06.2022

Numri i dokumentit: 03188338

PKR.nr.93/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Krimeve të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale kundër të akuzuarit N K, nga fsh., K. Istog, për shkak të kryerjes së veprës penale, *“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”*, nga neni 366 par.1, të KPPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për krime të rënda, PP/I. Nr.3/2022 të datës 18.05.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 21.06.2022, në prezencë të Prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj, të pandehurit N K dhe mbrojtësit të tij, av. Farauk Binakaj sipas autorizimit, të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 30.06.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N K, nga i ati H dhe e ëma F e gjinisë R, i lindur me dt. në fsh., I ku edhe banon në rr., i njejtë gjendet me punë në GJ. me vize punë i martuar, baba i pese fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i identifikuar me nr. personal ... posedon tel. me nr. telefoni ...shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet në liri.**

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Më parë dhe gjerë me datë 30.12.2021, rreth orës 07:20, në fshatin K. I., i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par. 1, të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll të paautorizuar, dhe atë: një pushkë automatike A..., kal. ..., me nr. serik-., dy karikator të pushkës në fjalë, një fishekë i kalibrit ..., po ashtu edhe një pushkë gjuetie, e modelit “K.M”, kal. ..., me nr. serikdhe njëzetegjashtë fishekë të pushkës së gjuetisë të kal. ..., në atë mënyrë që, ditën kritike në shtëpinë e të pandehurit, gjatë bastisjes nga ana e Policisë së Kosovës sipas urdhrit të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore Pejë-

DKR nën shenjën UGJK.nr.../..., fillimisht në dhomën e tij kanë gjetur pushkën automatike ndërkaq pushkën e gjuetisë e cila kishte qenë e babait të tij të ndjerë e kanë gjetur në një pjesë tjetër të shtëpisë të cilën e ka në shfrytëzim i pandehuri, më pas të gjitha armët me të dhënat e sipërsënuara janë sekuestruar nga ana e policisë,

- me çka ka kryer veprën penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par. 1, të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 8 par. 1 17, 21 par. 2 38, 39 par.1 nënpar.1.3, 43 par.1, 3, 69 par.1 pika 3.6 dhe 3.7, 70, 366 par.1 dhe par.3 të KPRK-së, si dhe neni 360, 365, 366, 453 par.3 të KPPRK-së, të njëjtit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- I. Në shumë prej 800 (tetëqind euro), të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaje në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgimi, duke llogaritur një ditë burgimi shumën prej 20 euro.
- III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej tridhjetë (30) € si dhe shumen prej 50 (pesëdhjete) euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Në kuptim të nenit 366 par.3, të KPRK-së, ndaj të pandehurit N K i shqiptohet:

DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI

KONFISKOHET një pushkë automatike A..., kal. ..., me nr. serik-..., dy karikator të pushkës në fjalë, një fishekë i kalibrit ..., po ashtu edhe një pushkë gjuetie, e modelit “K.M”, kal. ..., me nr. serikdhe njëzetegjashtë fishekë të pushkës së gjuetisë të kal.

URDHËROHET një pushkë automatike A..., kal. ..., me nr. serik-..., dy karikator të pushkës në fjalë, një fishekë i kalibrit ..., po ashtu edhe një pushkë gjuetie, e modelit “K.M”, kal. ..., me nr. serikdhe njëzetegjashtë fishekë të pushkës së gjuetisë të kal. ..., pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të **shkatërrohen**.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjën PP/I Nr. 3/2022 të datës 18.05.2022, kundër të akuzuarit N K nga fsh. , K. I, për shkak

të veprës penale, “**Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve**”, nga neni 366 par.1, të KPPK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 21.06.2022, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit, i pandehuri N K si dhe mbrojtësi i tij, av. F B sipas autorizimit si në shkresat e lëndës.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, nen shenjen PP/I Nr. 3/2022 të datës 18.05.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e **pranon fajësinë**, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë, është penduar shumë dhe ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërit veprime të tilla në të ardhmen.

Prokurorja e shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit N K ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, meqenëse ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Mbrojtësi i të pandehurit av. Fark Binakaj ka deklaruar se: *pasi që me të mbrojturin tim jemi konsultuar paraprakisht, të njëjtin e kam njoftuar për pasojat kushtet dhe privilegjet e pranimin të fajësisë, dhe pajtohem me pranimin e fajësisë, dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat vijuese: *Raportit të oficerit A.B#... i datës 30.12.2021; Urdhri për kontroll të shtëpisë dhe lokaleve tjera përcjellës nën UGJK.nr.../.. i datës 28.12.2021 i lëshuar nga gjykata; Deklarata e të pandehurit N K e dhënë në stacionin policor në Istog me datë 30.12.2021 si dhe deklarata e dhënë pranë kësaj prokurorie me datë 13.05.2022; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 30.12.2021; Procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm i datës 30.12.2021; Leja për mbajtje dhe përdorim të armëve të gjahut e datës 28.10.2004; Certifikata nën Nr./.. PV e datës 13.08.2015; Certifikata nën Nr./.. MV e datës 13.08.2015; Certifikata nën Nr./.. e datës 25.07.2015; Certifikata nën Nr./.. e datës 24.12.2015; Certifikata nën Nr./.. PV e datës 26.07.2017; Certifikata nën Nr. B-..../.. e datës 25.07.2015; Certifikata me nr. regj./.. e datës 21.03.2016; Raporti i shpejtë i datës 30.12.2021; Foto-dokumentacioni si dhe foto-albumi i përpiluar nga Njësia e Forenzikës i datës 30.12.2021 si dhe Leja për armë shenjëtarie nr. dhe shkresat e tjera të lëndës dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

Prokurorja e shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *meqenëse i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën e penale për të cilën është akuzuar i propozoj që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit si dhe të obligohet në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, po ashtu propozoj që si rrethanë lehtësuese të merret parasysht pranimi i fajësisë, mosdenueshmeria e tij në të kaluarën gjersa si rrethanë rënduese shkalla e lartë dashjes.*

Mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se: *meqenëse i mbrojturi im bëri pranimin e fajësisë gjykatës i propozoj që ti vlerëson këto rrethana, pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur pranë kësaj gjykatës, rrethanën që i njëjti nuk është recidivist, nuk ka të kaluarën kriminale, sjelljen e tij që nga faza e hetimeve në prokurori dhe tani në gjykatë, premtimin e tij të sinqertë që tani e tutje do të jete edhe me i kujdesshëm në sjelljet dhe veprimet e tij në shoqëri dhe rrethanën që i njëjti tashme është familjar, jeton në botën e jashtë por me të marr ftesën nga ana ime si mbrojtës ka shpreh gatishmëri që të jete prezentë dhe i është përgjigjur ftesës. Propozoj që ti shqiptohet një dënim me gjobë për arsyen që i njëjti gjendet në shtetin e Gjermanisë me vize pune si qytetari i këtij vendi dhe në të ardhmen planifikon që të merr edhe familjen e tij në shtetin e Gjermanisë dhe për të mos i paraqet pengese për rregullimin e dokumentacionit me rastin e aplikimit për bashkimin familjar. Premton pranë gjykatës që me të marre vendimin do ta respekton në tërësi.*

I pandehuri N K ka deklaruar se: *pajtohem me atë çka ka deklaruar mbrojtësi im, me vjen keq, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do ta përsëris veprimet e tilla.*

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPPK-së.**

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara e të përmendura nga ana e Prokurorit të Shtetit dhe mbrojtësit gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri në të gjitha fazat si dhe në shqyrtimin fillestar ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, po ashtu pendimin e tij për veprën e kryer, mosdenueshmerinë e tij të mëparshme, premtimin e tij, se nuk do ta përsëris veprimet e tilla në të ardhmen, sjelljen e tij korrekte në gjykatë, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata gjeti shkallen e lartë të dashjes për ta kryer këtë vepër penale.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të

akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me gjobe u morr konform nenit 40 par. 1 pika 1.3, nenit 43 dhe nenit 366 par. 1, të KRPK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit nga gjoba në dënim burgimi do merret në aplikim të nenit 43 par.3, të KRPK-ës, në rast kur i pandehuri nuk e paguan, refuzon apo dështon ta paguaj në shumën e cekur prej 800 (tetëqind) euro, si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi për konfiskim të armës dhe municionit, u morr konform nenit 366 par. 3 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.93/22 dt. 30.06.2022

Zyrtari ligjor
Alan Taranish

Kryetari i trupit gjykues,
Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.